

**VENDIM**  
**Nr. 228, datë 17.7.2023**

**MBI PËRCAKTIMIN E SHOQËRISË “BURSA SHQIPTARE E ENERGJISË ELEKTRIKE ALPEX” SHA SI OPERATORI I EMËRUAR I TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE (NEMO)**

*(Ndryshuar me vendim nr. 349, datë 22.11.2023)*

*(i përditësuar)*

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 7, pika 2 dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; të nenit 3, pikat 3 dhe 7, të “Rregullores së kërkesave dhe procedurave për përcaktimin e Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO)”, si dhe rolet e përgjegjësitë e NEMO-s dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë në tregun e bashkuar, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 40, datë 6.3.2020; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.7.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1395/8 prot., datë 14.7.2023, të Grupit të Punës, “Mbi përcaktimin e shoqërisë ‘Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX’ sh.a., si Operatori i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO)”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX” sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1395 prot., datë 10.5.2023, paraqiti aplikimin për t’u përcaktuar si Operatori i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) dhe me shkresat e protokolluara me nr. 1395/1 prot., datë 10.5.2023 dhe nr. 1395/2 prot., datë 2.6.2023, depozitoi dokumentacion shtesë të këtij aplikimi.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 200, datë 23.6.2023, vendosi të fillojë procedurën për përcaktimin e shoqërisë “Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX” sh.a., si Operatori i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO)”.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, u bë njoftimi në median e shkruar, i cili u botua përkatësisht në datat 28.6.2023 dhe 29.6.2023, dhe në përfundim të afatit 10-ditor të përcaktuar në këtë njoftim, nuk rezultoi të ketë ndonjë koment apo opinion nga palë të treta.

- Në lidhje me vendimin nr. 200/2023, ERE, me shkresën nr. 1395/5 prot., datë 4.7.2023, njoftoi Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Sekretariatën e Komuniteti të Energjisë, Autoritetin e Konkurrencës (AK), Zyrën e Rregullatorit për Energji të Republikës së Kosovës (ZRRE), Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a., Shoqatën Shqiptare të Furnizuesve të Energjisë (AAES), Shoqatën e Investitorëve të Huaj (FIAA) dhe Shoqatën Shqiptare të Energjisë së Rinovueshme (AREA).

- Ndërsa me shkresën nr. 1395/6 prot., datë 5.7.2023, njoftoi aplikuesin, shoqërinë “Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX” sh.a., në lidhje me dokumentacionin që mbetet ende për t’u plotësuar nga ky aplikim.

- Në përgjigje, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1397/7 prot., datë 14.7.2023, aplikuesi depozitoi dokumentacion plotësues të këtij aplikimi.

- Në zbatim të përcaktimeve të nenit 3, pikës 2, të “Rregullores së kërkesave dhe procedura për përcaktimin e Operatorit të emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO), si dhe rolet e përgjegjësitë e NEMO-s dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë në tregun e bashkuar”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 40, datë 6.3.2020, për t’u përcaktuar si NEMO aplikuesi ka plotësuar shtojcën 1.a., për të vërtetuar përmbushjen e kriterëve të përmendura në nenin 4 të kësaj rregulloreje, dhe ka paraqitur dokumentet e listuara në shtojcën 1.b.

- Për gjithë sa më sipër, vlerësohet që shoqëria “Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX” sh.a. të përcaktohet Operatori i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO).

- Për sa bërë me dije nga shoqëria, se programi ekonomik i ndryshuar për vitin 2023 do të përcillet për miratim pranë organeve drejtuese të ALPEX sh.a., vlerësohet që t’i lihet kusht asaj që të depozitojë në ERE këtë program të miratuar brenda 2 (dy) muajve.

- Operatori i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) është subjekt ligjor i përcaktuar nga Enti Rregullator i Energjisë për të kryer detyrat që kanë lidhje me bashkimin e tregut të ditës në avancë dhe të tregut brenda të njëjtës ditë, sipas kësaj rregulloreje. Monopoli ligjor në vend është caktimi i vetëm një Operatori të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike për sigurimin e shërbimeve të tregtimit të ditës në avancë dhe/ose tregtimin brenda ditës.

- Në referencë të përcaktimeve të nenit 3, pikës 3, të rregullores, vendimi i ERE-s bazuar në legjislacionin në fuqi përcakton dhe natyrën monopol të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike.

- Në zbatim të përcaktimeve të nenit 3, pikës 4, të rregullores, përcaktimi i Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) mbetet i vlefshëm deri në përfshirjen e rregullores së Alokimit të Kapaciteteve dhe Menaxhimit të Kongjestionëve në legjislacionin e vendit, sipas të cilës përcaktimi i NEMO-s duhet të konfirmohet bazuar në rregulloren e Alokimit të Kapaciteteve dhe Menaxhimit të Kongjestionëve (CACM *Regulation*).

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

#### VENDOSI:

1. Të përcaktojë shoqërinë “Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX” sh.a. si Operatori i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO).

2. *Shfuqizuar.*

3. *Shfuqizuar.*

4. Përcaktimi i NEMO-s, sipas pikës 1 të këtij vendimi, mbetet i vlefshëm deri në përfshirjen e Rregullores së Alokimit të Kapaciteteve dhe Menaxhimit të Kongjestionëve në legjislacionin e vendit, sipas të cilës përcaktimi i NEMO-s duhet të konfirmohet bazuar në Rregulloren e Alokimit të Kapaciteteve dhe Menaxhimit të Kongjestionëve (CACM *Regulation*).

5. Grupi i Punës të njoftojë aplikuesin, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Zyrën e Rregullatorit për Energji të Republikës së Kosovës, si dhe Sekretariatit të Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM  
ANËTAR I BORDIT  
**Erjola Sadushi**

